



**NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË
DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA**

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: +381 (0) 390 328-329

Nr. i Biznesit: 70325312
www.ngrohtorja.org

Më 03.10.2016
Nr. 1084

| | |
|--------|---|
| Për: | Z. Krenar Bujupi, u.d. Kryetar i Bordit te ZRRE-se |
| Cc: | Z. Astrit Saraqini, Udhëheqes i Departamentit per Energji Termike dhe Gas-ZRRE |
| Nga: | Admir Shala, Kryeshef Ekzekutiv i N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakove |
| Lënda: | Njoftim per mos-aplikim per tarifa te reja per sezonin 2016/2017 |

Të nderuar,

Në lidhje me shqyrtimin e tarifave për sezonin 2016/2017, dëshirojmë të ju njoftojmë me gjendjen aktuale në NQ Gjakova dhe me disa fakte, që sipas mendimit tonë e pamundësojnë një aplikim tarifor të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale, për një shqyrtim të mirëfilltë tarifor.

Meqenëse edhe në këtë sezon prodhimi i energjisë termike do të jetë i bazuar në lëndën djegëse – mazut, që për ne paraqet një kosto të papërballueshme financiare, operimi i NQ Gjakovë, do të jetë i varur nga subvencionet prej buxhetit të Kosovës edhe për vitin 2016 për çfarë tanimë janë siguruar mjetet financiare dhe kjo shpresojmë do të vazhdojë edhe në vitin 2017 ashtu që të mund të sigurojmë një furnizimi sadopak të qëndrueshëm gjatë sezonit 2016/2017. Kjo do na ndihmojë që të rikthejmë besueshmërinë tek konsumatorët, i cili ka filluar ngadalë që nga sezoni i kaluar.

Sic jeni në dijeni, NQ Gjakovë është përfituese e projektit në vlerë prej rreth 12 milion Euro të financuar nga BE-ja për ndërrimin e lëndës djegëse dhe jemi në fazën e fillimit të implementimit me çfarë do të ofrohet ngrohje e pandërprerë në të ardhmen për konsumatorët tanë andaj deri atëherë shpresojmë ti furnizojmë në kuadër të mundësive që na lejojnë. Posaçërisht zvogëlimi i numrit të konsumatorëve që furnizohen nga NQ Gjakova përgjatë viteve na obligon që, përkundër vështirësive financiare të vazhdojmë me operim dhe furnizim të konsumatorëve, ashtu që të mbajmë një kontinuitet deri në implementimin e projektit për impiantin e ri të kogjenerimit.

Nga sa u theksua me larte, konsiderojmë se në këto rrethana është vështirë të bëjmë një aplikim tarifor të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale.

Shpresojmë se do mirëkuptoni situatën tonë momentale dhe faktet e përshkruara më lartë

Me respekt,
Kryeshef Ekzekutiv i N.P. Ngrohtorja e Qytetit Sh.a. Gjakove
MSc, BSc Admir Shala